

VENDIM
Nr. 130, datë 7.3.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 997, DATË 10.12.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN
ME SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndarja I e vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit.”.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama